



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 378/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarën e lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit për rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si e bazuar ankesa e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, dhe **Anulohen** 77 fletëvotime të subjektit politik Gi Lista Srpska (GISL) me seli në Komunën e Graçanicës, në Vendvotimin BM106/002 të kandidatëve për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Sasha Milosavljeviq me nr.11, Jasmina Zivkoviq me nr. 12, Jelena Bontiq me nr. 13, Srdjan Mitroviq me nr. 14 dhe Sreten Ivanoviq me nr. 15, për Zgjedhjet Parlamentare të datës 11.06.2017.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj Vendvotimin BM106/002, të gjitha fletëvotimet e të gjitha subjekteve politike dhe të kandidatëve të tyre, duke i përjashtuar nga rezultati përfundimtar fletëvotimet si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 30.06.2017, nga koalicioni LDK-AKR me të cilën pretendon se me datë 28.06.2017 në Qendrën e Numërimit të Rezultateve në QNR, në Vendvotimin BM106/002 aktivistët nga radhët e koalicionit LDK-AKR, gjatë procesit të votimit kanë vërejtur pa rregullsi sepse fletëvotimet janë plotësuar me të njëjtën ngjyrë të stilolapsit sipas pretendimeve ankimore janë votuar të njëjtat numra të kandidatëve për deputet nga subjekti politik GISL. Nga të lartcekurat PZAP-it i ka kërkuar që të rishikoi kutin e votimit, bazuar në argumentet dhe konform rregullores së KQZ-së, që të anulohen fletëvotimet në fjalë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

**ankesa është e bazuar**

Paneli, me datë 01.07.2017, në përbërje të ekipit nga gjyqtarët dhe zyrtaret hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara. Kjo pasi që është bërë shikimi i fletëvotimeve një për një si dhe është bërë krahasimi i tyre dhe ka rezultuar se në Vendvotimin me Post BM106/002, nga të cilat fletëvotime, 61 prej tyre, mënyra e votimit ka qenë me shenjën “X”, për kandidatet e subjektit politik GISL me Nr.11, 12, 13, 14, 15, ndërsa për 16 fletëvotime mënyra e votimit ka qenë me shenjën “o”. Nga kjo paneli konstaton se fletëvotimet e lartpërmendura janë plotësuar nga i njëjti person dhe me të njëjtin laps kimik edhe përkundër faktit se mënyra e votimit është me post në vendvotimin e ankimuar, e që nënkuptohet se votuesit janë nga vende të ndryshme dhe fletëvotimet dorëzohen në pika të ndryshme postare.

Ekipi hetues i panelit, Fletëvotimet për të cilat pretendohet nga parashtruesi i ankesës se janë plotësuar nga i njëjti person dhe nga i njëjti laps kimik, pas shikimit të fletëvotimeve një për një si dhe është bërë krahasimit i tyre, të njëjtat i ka incizuar, **dhe të njëjtat janë veçuar dhe lidhur brenda kutisë së votimit dhe brenda fletëvotimeve të të njëjtit subjekt politik me lidhësen me ngjyrë të gjelbër me mbishkrim të kontrolluara nga PZAP-i dhe të nënshkruara nga zyrtari për hetimin e rastit.**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe gjetjeve nga ekipi hetues i PZAP-it, në QNR konkretisht në kutin e votimit të Vendvotimit BM106/002, erdhi në përfundim se në rastin konkret bëhet fjalë për plotësimin e fletëvotimeve nga i njëjti person – jo në mënyrë të ligjshme dhe të cilat veprime në bazë të LZP-së, përbejnë padrejtësi serioze. Andaj paneli duke u bazuar në nenin 119 par.5 të LZP-së, i cili përcakton se: *“PZAP-i, mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të ndryshme të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar një padrejtësi serioze”,* e më qëllim të evitimit të këtyre padrejtësive e duke u bazuar edhe nënenet 117 par.2, 118 par 1 dhe nenin 120 par.1 pika d, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 378/2017 më datën 02.07.2017.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.